

UNMIK/REG/2008/26
27 maj 2008

RREGULLORE NR. 2008/26

PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI ORGANIZATAT E BIZNESIT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në pajtim me Kapitullin 8 dhe paragrafët 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK -ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës, të datës 23 tetor 2007, lidhur me Ligjin mbi organizatat e biznesit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 shtator 2007,

Duke ditur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo pushtetin e tij të rezervuar dhe përgjegjësitë sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

A. Me anë të kësaj shall Ligjin mbi organizimin e bizneseve, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 shtator 2007 (Ligji nr. 02/L-123), i cili i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe bëhet i plotfuqishëm në datën e nënshkrimit duke iu nënshtruar ndryshimeve të parapara këtu dhe

B. Vendos që:

1. Ligji të implementohet në pajtueshmëri të plotë me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK -ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe me Rregulloren e UNMIK -ut nr. 2005/48 të datës 21 nëntor 2005, mbi riorganizimin dhe likuidimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe pasurive të tyre nën autoritetin administrativ të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

2. Në këtë Ligj do të bëhen ndryshimet vijuese dhe ato do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit :

(a) Në fund të nenit 1.2 shtohen fjalët vijuese: “Kushtet për raportimin financiar të organizatave të biznesit do të përcjellin rregullat e përfshira në Rregulloren e

UNMIK -ut 2001/30 të datës 29 tetor 2001 mbi themelimin e Bordit kosovar mbi standardet e raportimit financiar dhe një regjim për raportimin financiar të organizatave të biznesit, apo me ndonjë ligj tjetër të dekretuar për këtë qëllim”.

- (b) Në nenin 236.2., pas fjalëve “...do të shfuqizohet”, shtohen fjalët “vetëm për atë sa rregulloret tjera apo ligji në fuqi nuk i referohen asnjë dispozite të Rregullores 2001/6 dhe Urdhëresës administrative 2002/22”, dhe në fund të nenit 236.2 shtohet një fjali e re me këtë formulim: “Çdo dispozitë në Rregulloren 2001/6 dhe në Urdhëresën administrative 2002/22 të cilës i referohemi mbetet në fuqi dhe shfuqizon çdo dispozitë të këtij Ligji që nuk është në pajtim me Rregulloren 2001/6 dhe me Urdhëresën administrative 2002/22.”

E nënshkruar sot, më 27 maj 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm